



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.257/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Ferki Xhaferi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajë datë.06.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet ankesa Anr.257/2019, të datës 05.10.2019, e paraqitura nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, dhe subjektit politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, i shqiptohet gjobë, në lartësi prej 400.00€ (katërqind euro), për shkak të vazhdimit të sponsorimit të fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore, të cilën shumë, subjekti politik detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datë 05.10.2019, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.257/2019, nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, në të cilat pretendon se në llogarinë zyrtare në Facebook Ad library, shihet se në ditën e heshtjes zgjedhore me datën 05.10.2019, kandidatja për deputete nga radhet e subjektit politik LDK, Besa Gaxherri, në Facebook ka 2 reklama active. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provës materiale.

Subjekti politik LDK, në përgjigje në ankesë të datës 06.10.2019, konsideron se nga ka sqarim se cila pikë apo dispozitë e cilit nen apo paragraf është shkel, dhe se është kontrolluar nga zyra ligjore e LDK-së, dhe nuk është gjetur i sakt pretendimi i organizatës BIRN dhe

IKS. Në fund ka propozuar që ankesa e organizatës BIRN dhe IKS, të hudhet poshtë e pabazuar, ngase nuk ka sqarim se cila dispozitë është shkel.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli vlerësoi se ankesa Anr.257/2019, e datës 05.10.2019 e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, ndaj kandidatës për deputete Besa Gaxherri, nga radhët e subjektit politik Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), shihet se gjatë ditës së heshtjes zgjedhore me dt. 05.10.2019, dhe ditës së votimit dt. 06.10.2019, në llogarin e saj në rrjetin social facebook ka bërë fushatë zgjedhore dhe ka udhëzuar që të votohet nr. 134, veprim të cilin kandidatja për deputete Besa Gaxherri, e ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.


Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është përgjegjëse për veprimet e saja duke shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohet bërja fushatë në çfarëdo mënyre.

Paneli mbi bazën e të dhënave të lartcekuar në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.257/2019 më datë 06.10.2019**

Kryesues i Panelit

Adnan Konushevc



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.